



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME
SHOQËRIA "ILLYRIAN GUARD" SH.A.
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA JURIDIKE**



Nr. _____ Prot

Tiranë, më _____._____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

- **OBJEKTI I PROCEDURËS: "SHËRBIME TELEFONIKE (KARTA SIM DHE GPRS) 2026"** për nevojat e shoqërisë "Illyrian Guard" Sh.a.
- **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**
31712112-8 -KARTA SIM;
- **VLERA E FONDIT LIMIT:** 6,733,800 (Gjashte milion e shtatëqind e tridhjetë e tre mijë e teteqind Leke pa TVSH)

Sigurimi i ofertës 2% e fondit limit sipas nenit 30, pika 3, te VKM Nr.285, datë 19.05.2021 **134,676** (Njëqind e tridhjetë e katër mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë Lekë pa TVSH)

Në bazë të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 21, pika 2, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria "Illyrian Guard" SHA** ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në zbatim të urdhërit të prokurimit Nr. Prot 1124, datë 24.06.2026, të Administratorit, është ngritur Njësia e Prokurimit për hartimin e kriterëve të veçanta për procedurën me objekt: **"SHËRBIME TELEFONIKE (KARTA SIM DHE GPRS)"** për nevojat e shoqërisë "Illyrian Guard" sh.a ju informojmë për sa më poshtë:

Në mbështetje të termave të references dhe fondit limit propozojmë kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon:

I. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhër të Titullarit, në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenin 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar.

Kërkesat teknike janë përcaktuar mbi bazën e nevojave reale të Autoritetit Kontraktor, duke pasur parasysh natyrën e veprimtarisë së shoqërisë "Illyrian Guard" sh.a., e krijuar me VKM nr. 177, datë 04.04.2019, e cila, në përputhje me ligjin nr. 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" dhe aktet përkatëse në fuqi, ofron shërbime në fushën e sigurisë fizike, monitorimit elektronik dhe teknologjisë së informacionit në të gjithë territorin e Republikë së Shqipërisë.

Kartat SIM dhe shërbimi GPRS përbëjnë një element të domosdoshëm për funksionimin e sistemeve elektronike të monitorimit dhe transmetimin në kohë reale të të dhënave, duke garantuar komunikimin e pandërprerë ndërmjet pajisjeve në terren dhe qendrës së monitorimit.

Për këtë arsye, specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë proporcionale me nevojat funksionale të Autoritetit Kontraktor dhe synojnë garantimin e ofrimit të pandërprerë dhe cilësor të shërbimeve që shoqëria ofron.

II. ARGUMENTIMI VLERA LIMIT E KONTRATËS

Në përlllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, Autoriteti ynë kontraktor, ka zbatuar parashikimet e Nenit 76 të VKM Nr.285/2021, pika 1 b duke marrë oferta nga operatorët ekonomik të fushës. Ofertat janë administruar në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit dhe janë pjesë e dosjes.

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe*
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

III. ARGUMENTIMI KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenet 76 dhe 82 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", dhe nenin 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në të cilën është e përcaktuar se: "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa

vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83/1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Si dhe Nenit 83/2 ku përcaktohet se: *Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM Nr 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar :

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % të fondit limit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ne të cilin gjejmë të përcaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; dhe në nenin 43, pika 1 dhe 2 b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/entikontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

Si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë dhe të paraqesë certifikatat e konformitetit me Standartet ISO si më poshtë:

- Çertifikate Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit ISO 20000-1 mbi “Menaxhimin e shërbimit” ose ekuivalent
- Çertifikate e Menaxhimit të cilësisë të sistemeve ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent
- Çertifikate e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit ISO 27001, për menaxhimin e sigurisë së informacionit ose ekuivalent

ISO 20000-1 mbi “Menaxhimin e shërbimit” ose ekuivalent

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë të certifikuar në menaxhimin e shërbimeve në teknologjinë e informacionit. Përmbushja e standartit ISO 20000-1 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e

shërbimeve që parashikon kontrata. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të shërbimeve dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të shërbimit. Sistemi i menaxhimit të shërbimeve të IT konfirmon angazhimin e operatorit ekonomik për të ofruar dhe përmirësuar vazhdimisht cilësinë e shërbimeve.

Ofrimi i shërbimit, i përket fushës së teknologjisë së informacionit dhe është e nevojshme pajisja me këtë ISO nga kompania ofertuese për realizimin në mënyrë efikase dhe në përputhje me kërkesat e “Illyrian Guard” Sh.a. ISO 20000-1 është standardi ndërkombëtar për Menaxhimin e Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit (ITSM) i pranuar nga shumica e vendeve të botës. Standardi përshkruan një seri procesesh menaxhimi të krijuara për të ndihmuar kompanitë të ofrojnë shërbime më efektive të IT (si për ato brenda kompanisë ashtu edhe për klientët e tyre), jep metodologjinë dhe kornizën për të ndihmuar kompanitë të menaxhojnë ITSM. Me kërkesat e standardit kompanitë aplikojnë praktikatat më të mira, duke ndihmuar në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve IT.

ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe, nenit 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Përmbushja e standartit ISO 9001 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së mallrave që parashikon kontrata. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të cilësisë. Nisur nga proceset e punës dhe shërbimeve që ai ofron, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik proceset e punës së tij, t’i bazojë në standarde botërore, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në cilësi, shpejtësi, efikasitet dhe të shërbimeve të ofruara.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori ekonomik zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilësor të tij.

ISO 27001, për menaxhimin e sigurisë së informacionit ose ekuivalent

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatori ekonomik që do të zbatojë kontratën të jetë i certifikuar në sigurinë e informacionit.

Përmbushja e standartit ISO 27001 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e të dhënave në mënyrën e duhur. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik përmbush standartet për sigurinë e informacionit gjatë zbatimit të kontratës. Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit siguron që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përjasje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria.

Çertifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizëm kombëtar i akreditimit, ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat ISO duhet të jenë brenda periudhës së vlefshmërisë. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili operator ekonomik duhet të disponojë certifikatat ISO sipas zërave/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë.

2.3.3. OE për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar për muajin e fundit, të paktën 5 (pesë) persona të vërtetuar me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit.
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar vërtetuar me listëpagesat E-sig ,

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë minimalisht 2 punonjës të diplomuar në fushat Elektronike/Informatikë/Teknologji Informacioni ose ekuivalente të fushës së IT.

Për punonjësit e mësipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- *Listëpagesat sipas formatit E-sig për muajin e fundit.*
- *Diplomat e arsimit të lartë të kërkuara, origjinale ose të noterizuara/ Vërtetim diplomimi*
- *Kontratat e punës*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 10, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër.

Argumentim: Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar. Për të vërtetuar që Operatori Ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit.

Kërkesa për të paktën dy punonjes garanton mbulimin e proceseve teknike, menaxhimin e njëkohshëm të detyrave dhe trajtimin në kohë të çështjeve teknike gjatë zbatimit të kontratës, duke reduktuar rrezikun e vonesave apo mosrealizimit sipas specifikimeve.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar pranë regjistrit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për të gjitha shërbimet e kërkuara ose i autorizuar nga Autoriteti i

Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për ofrimin e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, që përfshijnë shërbimet objekt të kësaj procedure. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e Regjistrimit/Autorizimin e Përgjithshëm nga të cilat rezulton e drejta për të ofruar shërbimet e kërkuara.

Argumentimi: Referuar nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e certifikatës /autorizimit nga AKEP, për shërbimin objekt kontrate, është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të kërkojë garanci mbi cilësinë e shërbimeve dhe të teknologjisë përkatëse që do të përdoret.

Kërkesa që operatorët ekonomikë të disponojnë certifikate/autorizim të lëshuar nga AKEP për ofrimin e shërbimeve të telefonisë celulare, kartave SIM dhe transmetimit të të dhënave (GPRS/Data) (shërbimet e kërkuara në këtë procedure) është vendosur në funksion të verifikimit të perputhshmërisë ligjore të operatoreve ekonomike për të realizuar objektin e kontratës, duke qenë se regjistrimi dhe autorizimi nga AKEP është një detyrim ligjor për të gjithë operatorët që ushtrojnë veprimtarinë objekt të kësaj procedure.

Objekti i procedurës konsiston në ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, të cilat, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, mund të ofrohen vetëm nga operatorë të autorizuar nga AKEP. Për këtë arsye, disponimi i autorizimit është një kusht ligjor të domosdoshëm për ushtrimin e aktivitetit ekonomik që përbën objektin e kontratës.

Kërkesa është drejtpërdrejt e lidhur me objektin e prokurimit, pasi shërbimi telefonik realizohet nëpërmjet rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, kartat SIM mund të ofrohen vetëm nga operatorë të autorizuar për ofrimin këtyre shërbimeve, shërbimi GPRS/Data është pjesë e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe kërkon autorizimin përkatës për transmetimin e të dhënave.

2.3.6. Operatori Ekonomik duhet të ketë mbulim me rrjet 4G LTE për të paktën 98.5 % të popullsisë së Shqipërisë.

Kjo duhet të vërtetohet me dokument përkatës nga AKEP.

Argumentimi Ligjor: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të LPP dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

Argumentimi Teknik: Ky kriter është vendosur për të garantuar që shërbimet e komunikimit përmes SIM kartave të jenë të disponueshme dhe funksionale në pjesën më të madhe të territorit të Republikës së Shqipërisë. Sigurimi i një niveli të lartë mbulimi (98.5%) është thelbësor për të garantuar akses të vazhdueshëm në shërbimet e të dhënave dhe komunikimit, veçanërisht për aktivitetet në terren. Verifikimi përmes dokumentacionit nga AKEP siguron besueshmëri dhe transparencë mbi kapacitetet reale të operatorit ekonomik.

2.3.7. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër të gjitha Kërkesat Funksionale dhe Specifikimet Teknike të kërkuara nga AK.

Argumentim: Ky kriter është jo diskriminues është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe është përcaktuar në mënyrë që AK të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do t'i përgjigjet kërkesave të AK me qëllim realizimin me sukses të kontratës dhe në mbështetje të nenit 77, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 6 të Nenit 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Njësia e Prokurimit